



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 40 shkronja (h) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në mbështetje të neneve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 të datës 04 qershor 2008, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 8 paragrafi 1 pika 1.2 dhe nenit 14 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 datë 3 Prill 2019, nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës të datës 13.08.2020 dhe nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë \_\_\_\_\_ 2024, të miratojë këtë:

PROPOZIM

## V E N D I M

### PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS ZK-LIPJAN

#### Neni 1

Me këtë Vendim i'u jepen në shfrytëzim afatgjatë personave fizik dhe juridik paluajtshmerit-pronat komunale që gjenden në Zonën Kadastrale në Lipjan të përshkruara si në vijim:

Njësia Kadastrale P-71409044-01736 -2, në sipërfaqe prej 1457m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale në Lipjan;  
Njësia Kadastrale P-71409044-01742 -4, në sipërfaqe prej 624m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale në Lipjan;  
Njësia Kadastrale P-71409044-01743-5, në sipërfaqe prej 803m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale në Lipjan;  
dhe Njësia Kadastrale P-71409044-01748-2, në sipërfaqe prej 765m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale në Lipjan

Sipërfaqja e përgjithshme e pronave 3649m<sup>2</sup>.

## Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të këtyre pronave është ndërtimi i ndërtesave për banim të përballushëm. Me ndërtimin e ndërtesave në këto parcela, do të bëhet rrënimi i dy objekteve të vjetra banesore të cilat nuk i plotësojnë kushtet e banimit, po ashtu në të njëjtin proces mundësohet edhe zhvillimi i pronave private në sipërfaqe të përgjithshme prej 1156.07m<sup>2</sup>, si dhe do të bëhet rregullimi i qendrës së qytetit-Zona e parë I-rë, sipas kushteve të përcaktuara me Harten Zonale të Komunës së Lipjanit, në këto parcela është paraparë ndërtimi i lartë banesor dhe afarist me etazhitet B=P+8.

## Neni 3

Pronat e paluajtshme komunale sipas nenit 1 të këtij Vendimi jepen në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite nëpërmjet procedurës së Njoftimit publik nga ana e Komisionit Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal.

## Neni 4

Procedura e dhënies në shfrytëzim të pronave të komunës të përcaktuara në nenin 1 të këtij Vendimi bëhet përmes “Shprehjes së Interesit”, duke i plotësuar edhe kriteret tjera të përcaktuara në nenin 5 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

## Neni 5

Zgjedhja e ofertës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës, bazohet në kriteret e përcaktuara në nenin 20 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës përmes “Shprehjes së Interesit”.

## Neni 6

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës sipas nenit 1 të këtij Vendimi t’i regjistroj në librat kadastral si prona të dhëna në shfrytëzim në afat prej 99 vitesh sipas procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

## Neni 7

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori Pronëso- Juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Inspektion.

## Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.



## A r s y e t i m

Baza ligjore për miratimin e këtij propozim-Vendimi është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Pronat komunale të propozuara sipas nenit 1 të këtij Vendimi i'u jepen në shfrytëzim për periudhën afatgjate prej 99 vitesh nëpërmjet procedurës së Njoftimit publik nga ana e Komisionit Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal dhe të njëjtat janë publikuar brenda afatit ligjor në faqen zyrtare të komunës sipas aktit të Zyrës së Kryetarit-Sektorit Pronësor-Juridik 01-462/01-68402 datë 15.02.2023 të listës së veçantë të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues 2024, konform dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Komuna ka obligim ligjor t'i ushtroj kompetencat vetanake. Në këtë kuptim, në nenin 17, pika l) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale parashihet që banimi publik është njëri nga funksionet që Komuna ka për obligim ta ushtroj për qytetarët e saj. Andaj, projekti në fjalë është në harmoni me funksionet bazike (elementare) të përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.

Dhënia e pronave komunale në shfrytëzim si në nenin 1 të dispozitivit të këtij Vendimi, bëhet me qëllim të ndërtimit të ndërtesave me destinim banim dhe afarizëm dhe për interes publik. Në pjesën e përfutur të ndërtesave që do të ndërtohen në këto parcela, synohet të ofrohen banesa për banim të përballueshëm për kategoritë sociale dhe kategoritë tjera në nevojë, si dhe për ta përmirësuar gjendjen e banimit në qendrën e qytetit.

Po ashtu, në interes publik është edhe rregullimi i bllokut që gjendet në qendër të qytetit, i cili duhet riorganizuar dhe zhvilluar sipas zonimit dhe kushteve të përcaktuara me Hartën Zonale të Komunës së Lipjanit. Gjithashtu rregullimi i këtij blloku përcillet me krijimin e hapësirave me gjelbërim, të cilat do të jenë të qasshme jo vetëm për banorët e Ndërtesës por edhe për qytetarë të tjerë.

Në bazë të studimit të fizibilitetit ka rezultuar se "Dhënia në shfrytëzim e pronës" është opsioni më i favorshëm për Komunën e Lipjanit. Si një alternativë ndaj modelit për Partneritet Publiko Privat (PPP) apo modelit të prokurimit publik, dhënia në shfrytëzim e pronës identifikohet si një opsion i favorshëm që mund të i tejkaloj mangësitë buxhetore që ndodhen në modelin PPP dhe të prokurimit publik. Përveç kësaj ky opsion është i vetëm edhe për shkak të kufizimeve teknike (mungesa e sipërfaqes si tërësi së paku prej 2000m<sup>2</sup> për parcelen/at ndërtimore), meqenëse parcelat janë të ndara dhe ndërmjet tyre ka prona private. Ndërlidhur me këte ka kufizime ligjore për modelin e PPP për shkak se blloku mund të zhvillohet vetëm si i përbashkët, duke përfshirë edhe pronat private.



Dhënia në shfrytëzim e pronave është zgjidhja më e favorshme për vlerën për para, sipas analizave të detajuara të inkorporuara në studimin e fizibilitetit, duke pasqyruar implikimet financiare dhe aspektet ligjore. Sipas rezultateve nga studimi i fizibilitetit do të arrihen këto përfitime:

1. Rritja e vlerës së tokës pa investim direkt shtesë nga Komuna: Me ofrimin e pronave të paluajtshme komunale në shfrytëzim, Komuna rrit vlerën e paluajtshmërive pa realizuar investime direkte shtesë meqë këto barten nga përfituesi i shfrytëzimit dhe mund të jenë si parakushte për dhënie në shfrytëzim, në linjë me objektivat e vendosura në Ligjin Nr.06/L-092.

2. Dhënia në shfrytëzim ruan dhe respekton karakteristikat e pronës dhe është në harmoni me Hartën Zonale Komunale: Një ndër objektivat e vendosura në Ligjin Nr. 06/L-092, është që prona e dhënë në shfrytëzim të ruaj karakteristikat e shfrytëzimit. Në këtë kontekst, Harta Zonale Komunale veçse ka paparë ndërtim në bllokun urbanistik të evidentuar si më lartë dhe rrjedhimisht konsiderohet që është në përputhje të plotë me objektivat e përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L-092.

3. Realizimi i të hyrave shtesë: Përmes këtij opsioni Komunës së Lipjanit nuk do t'i shkaktohen kosto të shpenzimeve për arritjen e objektivave në mënyrë të përmbushjes së nevojave të identifikuar me këtë studim, si dhe do të siguroj të hyra në periudha periodike në emër të dhënies në shfrytëzim.

4. Interesi publik: Përveç tjerash ndërlidhet edhe me kompetencat vetanake të komunave në fushën e banimit dhe përkuqdesjes sociale.

Prandaj dhënia në shfrytëzim e pronave komunale konsiderohet njëra prej teknikave ligjore që mundëson arritjen e këtyre objektivave:

- a) Të siguroj shfrytëzim efektiv të pronës së paluajtshme për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;
- b) Të rritë vlerën financiare të pronës së paluajtshme; dhe
- c) Të përmbush interesin e përgjithshëm (publik).

Nga ndërtimi i ndërtesave, përfitimi për komunën do të jetë në përqindjen më të lartë që ofrohet në konkurrencë të hapur, konkuruuese dhe kritereve të tjera vlerësuese.

Gjatë procesit të studimit të fizibilitetit dhe analizimit të përfitimeve të komunës për mbulimin e nevojave të banimit për rastet sociale është vërtetuar se interesi i Komunës është të marrë banesa të ndërtuara, me qëllim të plotësimit të interesit publik për ofrimin e banimit për kategoritë sociale dhe kategoritë tjera në nevojë.

Dhënia në shfrytëzim e këtyre pronave i plotëson kriteret në mënyrë komulative sipas nenit 5 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Procedura e zgjedhjes së ofertës për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës, bazohet në kriteret e përcaktuara në nenin 20 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës përmes “Shprehjes së Interesit”. Pas përfundimit të gjitha procedurave rreth vlerësimit, përzgjedhjes së ofertës dhe procedurave lidhur me ankesat eventuale, Komisioni Vlerësues me raportin mbi punën e kryer e rekomandon për miratim në Kuvendin Komunal ofertën ekonomisht më të favorshme.

Duke pasur parasysh kohëzgjatjen e dhënies në shfrytëzim të pronave komunale, aplikohet procedura e “Shprehjes së interesit” konform nenit 8.1 (1.2) të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Ndërlidhur me këtë, do të aplikohen të gjitha kriteret ligjore të kësaj procedure.

Me qëllim të realizimit të interesit publik, rritjes së vlerës së pronës publike komunale dhe rregullimit të qendrës së qytetit sipas kushteve të përcaktuara urbane, kërkojmë nga Kuvendi Komunal miratimin e këtij propozim-Vendimi.

01-462/02-14777  
Lipjan, më 14.03.2024

KRYETARI KOMUNËS

Imri Ahmeti







## Republika e Kosovës

Republica Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY



## CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

### NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71409044-01736-2

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

1263/2024  
13.03.2024 - 09:17

Komuna / Opština / Municipality:

LIPJAN / LIPLJAN / LIPIJAN

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Lipjan / Lipjan / Lyipjan

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

LIPJAN / LIPLJAN / LIPIJAN

### A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Përkrahim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71409044-01736-2	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urban	1457	20-1993	22.01.2024	

### A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
VAROSH			22.01.2024	



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJIA / TYPE OF USE

Numbri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parces Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parces Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kvalitet klase Quality/ Class	Shprehja e Pozimit Area
1	Bujqesore/Poljoprivredno/Agriculture	Arat/Njive/Arable	Arë E Klases 1/Njiva I Klase/1st Class Arable Land	1457



B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostni adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drazvina / Single possessor	Komuna e Lipjanit	600371588	/ / /		SHQIPËRIA	1/1	20-1993	14.02.2024





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS  
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE  
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : LIPJAN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Lipjan

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m <sup>2</sup>
P-71409044-01736-2	Parcelë / Parcela / Parcel	1457
O-71409044-01736-0-48-0	Ndërtesë / Zgrada / Building	232



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1000

Punoi/Obradio/Created: Ramadan Hoxha

Nënshkrimi/Potpis/Signature:


Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 13.03.2024

Koha/ Vreme/ Time: 09:15:18





1736-2





## Republika e Kosovës

Republica Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Živote Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure / AGENCIJA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

### CERTIFIKATË / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71409044-01742-4

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

1263/2024  
13.03.2024 - 09:17

Komuna / Opština / Municipality:


Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:  
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: LIPJAN / LIPJAN / LIPJAN

#### A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-71409044-01742-4	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urban	624		22.01.2024	

#### A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
VAROSH			22.01.2024	





## A.2 LLOJË I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelë Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelë Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Supërfaqja Përfaqja Area (m <sup>2</sup> ) (m <sup>2</sup> ) (m <sup>2</sup> )
1	Bujqësore/Pojiprivredno/Agriculture	Arat/Njive/Arable	Arë E Klasës I/Njiva I Klase/1st Class Arable Land	624

## B. PRONAR/POSEDEUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Liceni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Postanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhurnuar Azurnirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Lipjanit	600371588	///		SHQIPËRIA	1/1		14.02.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS  
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE  
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : LIPJAN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Lipjan

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m <sup>2</sup>
P-71409044-01742-4	Parcelë / Parcela / Parcel	624
O-71409044-01742-3-47-0	Ndërtesë / Zgrada / Building	288



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1000

Punoi/Obradio/Created: Ramadan Hoxha

Nënshkrimi/Potpis/Signature:


Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 13.03.2024

Koha/ Vreme/ Time: 09:15:59





1742-4





Republika e Kosovës

Republica Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

## CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71409044-01743-5

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

1263/2024

13.03.2024 - 09:17

LIPJAN / LIPLJAN / LIPIAN

Lipjan / Lipjan / Lypjan

LIPJAN / LIPLJAN / LIPIAN

LIPJAN / LIPLJAN / LIPIAN

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

Komuna / Opština / Municipality:

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

### A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Përkrahim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71409044-01743-5	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urban	803		22.01.2024	

### A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postar Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
VAROSH			22.01.2024	



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJIA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta korisçenja parcelë Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno korisçenje parcelë Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Površina Area (m <sup>2</sup> )
1	Bujqësore/Pojtoprivedno/Agriculture	Arat/Njive/Arable	Arë E Klases 1/Njiva I Klase/1st Class Arable Land	803



B. PRONAR/POSEDEUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhurnuar Ažurirano Updated
Posedim individual/ Individualna Drazvina / Single possessor	Komuna e Lipjanit	600371588	///		SHQIPËRIA	1/1		14.02.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS  
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE  
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : LIPJAN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Lipjan

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m <sup>2</sup>
P-71409044-01743-5	Parcelë / Parcela / Parcel	803
O-71409044-01742-3-47-0	Ndërtesë / Zgrada / Building	288
O-71409044-01747-0-46-0	Ndërtesë / Zgrada / Building	297



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1000

Punoi/Obradio/Created: Ramadan Hoxha

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 13.03.2024

Koha/ Vreme/ Time: 09:16:40





1743-5





Republika e Kosovës  
Republica Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjetit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71409044-01748-2

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:  
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:  
Komuna / Opština / Municipality:  
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:  
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

1263/2024  
13.03.2024 - 09:18  
LIPJAN / LIPLJAN / LIPIAN  
Lipjan / Lipjan / Lyipjan  
LIPJAN / LIPLJAN / LIPIAN

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Përkthim Opis Description	Krijtar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71409044-01748-2	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Urban	765		24.01.2024	

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijtar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
VAROSH			24.01.2024	



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelë Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelë Parcel Current Use	Kualiteti i Klasesë Kvalitet Klase Quality/Class	Sipërfaqja (m <sup>2</sup> ) Površina (m <sup>2</sup> ) Area
1	Bujqësori/Poljoprivredno/Agriculture	Arat/Njive/Arable	Artë E Klasesë I/Njiva I Klase/1st Class Arable Land	765

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo inovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drazvina / Single possessor	Komuna e Lipjanit	600371588	/ / /		SHQËPËRIA	1/1		14.02.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS  
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE  
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : LIPJAN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Lipjan

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m <sup>2</sup>
P-71409044-01748-2	Parcelë / Parcela / Parcel	765



Shkalla/Razmera/Scale: 1:757

Punoi/Obradio/Created: Ramadan Hoxha

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 13.03.2024

Koha/ Vreme/ Time: 09:17:29





1748-2